



PROGRAMI
BUXHETOR
AFATMESEM
2025-2027

Faza e Parë

LËNDA

1. HYRJE	1
1.1 PROÇESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ	1
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	3
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË.....	5
3. PRIORITETET AFATMESME 2025-2027	9
3.1 Objektivat Strategjikë	9
3.2 Projekte Strategjike	13
4. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË TIRANË PËR PERIUDHËN 25-27	15
5. BUXHETI AFATMESËM SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE NJËSIVE SHPENZUESE.....	20
6. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2025-2027	
6.1 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2025 -2027	44
6.1.1 Shpenzime Kapitale.....	45
6.1.2 Shpenzime për Personelin.....	45
6.1.3 Shpenzime Operative dhe të tjera	46
7. Lista Raporteve	
a) Raporti PBA1: Tavanet Pergatitore te PBA	
.....	
b) Raporti PBA2: Parashikimi i te Ardhurave	
.....	
c) Raporti PBA3: Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik	
.....	
d) Raporti PBA4: Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III COFOG).....	
e) Raporti PBA5: Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik.....	
f) Raporti PBA6: Deklarata e Politikës së Programit.....	
g) Raporti PBA7: Shpenzimet e Produkteve të Programit	
.....	
h) Raporti PBA8: Projektet e Investimeve	
.....	
i) Raporti PBA9: Informacion mbi NJVQV/Programin.....	

HYRJE

1. 1 PROÇESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM FAZA E PARË

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe realizimin e shpenzimeve për shërbime publike.

Programi buxhetor afatmesëm vendor ka për qëllim të bëjë të zbatueshëm planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë trevjeçare. Programi buxhetor afatmesëm pasqyron mënyrën e krijimit dhe të shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme të saj në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë menaxhimin e sistemit buxhetor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifatat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë.

Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njërive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korrente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Kush përfshihet në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA):

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e Varësisë

PBA-ja është hartuar në bazë të funksioneve, ku çdo funksion lidhet me disa programe të pushtetit vendor, brenda të cilave janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse për të cilat janë krijuar këto njësi. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me Strategjitë 4 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë dhe programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Tiranë sipas grupeve kryesore janë:

- a. Shpenzimet e Personelit (paga, sigurime)
- b. Shpenzime operative
- c. Shpenzimet kapitale
- d. Fondi rezervë
- e. Fondi i kontigjencës

1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË

Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit vjetor të vitit 2024” ka miratuar dhe kalendarin e përgatitjes së PBA 2025-2027. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, në rolin e nëpunësit autorizues, me Urdhërin Nr. 1187, datë 17.04.2024 “Për ngritjen e grupit për menaxhim strategjik” ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik i cili është përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të planifikimit për Bashkinë Tiranë, si dhe me Urdhërin Nr. 1188, datë 17.04.2024 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve” ka ngritur grupet e menaxhimit të programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Në zbatim të Udhëzimit Nr.3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 37, datë 28.03.2024 janë miratuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2025-2027, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese.

Këtë vit, për herë të parë, në zbatim të Udhëzimit Nr. 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027 dhe buxhetit vjetor do të përgatitet jo më sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar por nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor, si një aplikacion interaktiv i mbështetur nga një bazë të dhënash, i cili do të lehtësojë dhe do të sigurojë gjithëpërfshirjen e të gjitha palëve përgjegjëse në procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, nga formatet elektronike të të cilës varet edhe miratimi teknik i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Pavarësisht sa sqaruar më sipër, në cdo rast, formatet e përdorura për miratimin e PBA janë konform kërkesave ligjore për planifikimin buxhetor, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm si pema e programeve me qëllimet e objektivat, pema e produkteve, klasifikimi buxhetor, klasifikimi ekonomik, klasifikimi në bazë artikujsh e llogarish buxhetore, etj.,

Udhëzimi Standart i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore.

Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;

- Proçedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor).

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Proçesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proçeset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027 dhe buxhetit vjetor është përgatitur nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV). Nga Ministria e Financave është vënë në dispozicion një llogari përdoruesi që përkon me rolin e Sekretarit të GMS (Nëpunësit Zbatues), i cili më pas ka patur mundësinë të krijojë llogaritë për përdorimin e SMBV për anëtarët e tjerë të stafit të Bashkisë Tiranë bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e tyre në proçesin e PBA dhe Buxhetit Vjetor.

Faza 1 e proçesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik të burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti.

Faza 2 e proçesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje

me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË

Bashkia e Tiranës me një sipërfaqe totale prej 1,111 km² kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Kjo bashki përbëhet nga 24 njësi administrative si dhe 3 Lagje, të cilat janë: 11 Njësitë Administrative Urbane, zonat rurale si Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri si Lagjia 12, Lagjia 13 dhe Lagjia 14.

Tirana është bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësi. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit.

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqëndrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Gjatë vitit 2023 në Republikën e Shqipërisë u krye Censi i 12-të, që kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur në vitin 1912, ku Censi i parë u krye në vitin 1923 dhe më i fundit në vitin

2011. Sipas informacionit të publikuar nga Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë informacioni në nivel bashkie do të lançohet vetëm në tetor të vitit 2024, çka e ka bërë të pamundur përdorimin e informacionit të gjeneruar prej tij në hartimin e politikave brenda territorit të Bashkisë Tiranë gjatë hartimit të Fazës së Parë të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027.

2. PRIORITETET AFATMESME 2025-2027

Bashkia Tiranë në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi ka ndërmarrë nismën për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027 (SZHQBT) që është instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor. Bashkia Tiranë nëpërmjet kësaj strategjie synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit. Zhvillimi i qëndrueshëm nga këndvështrimi i këtij dokumenti është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një manaxhim të suskseshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Vizioni ynë për pesë vitet e ardhshme projektton Tiranën si një qytet i aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike në nivel kapilar; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike; një qytet gjithëpërfshirës që prioriteton ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet SZHQBT janë pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë 2015 – 2030 dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Në evidentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale, rekomandimet nga vlerësimi i strategjisë së mëparshme si dhe aplikimi i metodologjisë së Këshillit të Europës për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe aktorëve të interesit gjatë hartimit të këtij dokumenti.

Në vijim paraqesim projektet madhore me rëndësi strategjike të Bashkisë së Tiranës të cilat janë projekte në vazhdim dhe do të vijojnë dhe për 3 vjeçarën e ardhshme.

Projektet strategjike të Bashkisë Tiranë për periudhën 2025-2027:

- Teatri i ri i Tiranës,
- Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik- TEDA,
- Tirana Policentrike,
- Zgjerimi i Lumit Lana,
- Unazat e Tiranës
- Transporti i Gjelbër në Tiranë – Green Transport Tirana
- Muzeu i Tiranës
- Stadiumi Lojrave me Dorë
- Stadiumi ‘Selman Stërmasi’
- Kopshti Botanik

- Qendra e Konventave, Ekspozitave
- Qendra Ndërkombëtare e Panaireve
- Muzeu i Artit Modern

Informacion më i zgjeruar mbi disa prej projekteve me te rendesishme po e paraqesim si me poshte:

TEATRI I RI I TIRANES

Kryeqyteti ka nevojë për një godinë të re të Teatrit Kombëtar që plotëson të gjitha standartet ndryshe nga ai ekzistues. Shtëpia e re e aktrimit është konceptuar të jetë si zemra kulturore e Tiranës dhe e gjithë Shqipërisë dhe e dedikuar vetëm për art. Projekti i prezantuar nga një nga studiot më të mëdha ndërkombëtare të arkitekturës në botë, “Bjarke Ingels Group” me qendër në Danimarkë, ofron një godinë të arkitekturës me dizajn modern dhe që krijon një hapësirë unike në qytetin e Tiranës, duke ofruar të gjitha kushtet e nevojshme dhe frymëzuese për zhvillimin e talentit të aktrimit, ashtu edhe për vetë publikun i cili mund të angazhojë imagjinatën.

Projekti gjithashtu garanton një akses të këmbësorëve që përdorin rrugën “Sermedin Said Toptani” në rrugën paralele me të. Hyrja kryesore në teatër është e mundur përmes shëtitorës “Murat Toptani”, ndërsa hapësira e sheshit publik në nivelin përdhes, siguron hyrje të mbuluar në teatër, së bashku me hapësirën publike për mbledhje ose argëtim. Me ndërtimin e teatrit të ri aktorët do kenë mundësi të punojnë në ambiente kontemporane, cilësore dhe jo të dëmshme për shëndetin e tyre. Njëkohësisht edhe qytetarët do të kenë mundësi të shijojnë artin e ofruar nga artistët në ambiente të rehatshme me të gjitha kushtet që meriton të ketë një godinë e tillë.

Punimet në objektin “Ndërtimi i objektit “Godina e Teatrit Tiranë – Faza I-rë” janë në fazën e mbrojtjes së gropës së themeleve ku përfshihen ndërtimi i diafragmave beton arme, ndërtimi i ankerave, trari udhëzues i mbrojtjes së themeleve, realizimi i pilotave të armuara, gërmime, etj. Progresi deri më 31.05.2024 është 14% e vlerës totale të kontratës.

ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK- TEDA

Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, TEDA Tirana (Technological Economic Development Area), do të jetë një pol i zhvillimit ekonomik që do të tërheqë Investime të Huaja Direkte në Tiranë duke ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit.

Tirana është tregu më i madh i punës në vend dhe ka një pozicionim mjaft të favorshëm gjeografik sa i përket eksportit. Fuqia punëtore e re dhe e kualifikuar, si dhe pozita mjaft e favorshme gjeografike e vendos TEDA Tirana në një pozicion të favorshëm jo vetëm me TEDA-t e tjera në vend, por edhe me zonat e tjera të ngjashme në rajon.

Misioni: Krijimi dhe funksionimi i një Zone Teknologjike të Zhvillimit Ekonomik konkurrense në tregun global, me prosperitet të lartë dhe e orientuar nga zhvillimi i qendrueshëm ekonomik mundësi për punësim dhe infrastrukturë konkurruese.

Qëllimi: Funksionimi i TEDA Tiranë synon krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor tepër lehtësues për ushtrimin e aktivitet ekonomik që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përshejtmën e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përshejtmën e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve.

Një nga konceptet e synuara risi të këtij projekti është ai i “Greenfield” ose, me fjalë të tjera, i personalizuar që në themele. Investitorët e interesuar do të kenë mundësinë të marrin truallin që u nevojitet dhe të ndërtojnë vetë, në bazë të specifikave përkatëse, facilitetet e nevojshme për vendosjen e impianteve të prodhimit.

Në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 169, datë 20.03.2024, është lidhur kontrata ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Bashkia Tiranë, për ndërtimin, administrimin dhe monitorimin e funksionimit të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Tiranë (TEDA Tiranë) me objekt dhënien e të drejtave ekskluzive zhvilluesit (Bashkisë Tiranë) nga ana e institucionit përgjegjës (MEKI) për projektimin, financimin, ndërtimin, administrimin dhe monitorimin e funksionimit të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Tiranë. Si rrjedhim, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 54, datë 30.05.2024 “Për krijimin e shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e akteve të themelimit” është krijuar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin tregtar “TEDA TIRANË” sh.p.k, shoqëri e zotëruar 100% nga ortaku i vetëm Bashkia Tiranë.

ZGJERIMI I LUMIT LANA

Rehabilitimi i Lanës është një tjetër projekt madhor me impakt zgjerimin e aksit infrastrukturor lindje-perëndim, si dhe eliminimin e përmytjeve në segmentet fundore perëndimore të Lanës. Ky projekt i jep fund edhe historisë së gjatë të lumit të qytetit - një histori me tre epoka: (1) atë të informalitetit (2) atë të rikthimit në identitet dhe rigjëlberimit të Lanës, (3) dhe epokën e sotme, zgjerimin e Lanës dhe transformimin e saj në një aks të gjelbër, që kalon tej për tej qytetit, me fokus mobilitetin e qendrueshëm urban, autobusët dhe biçikletat.

Puna për zgjerimin e Lanës po vazhdon dhe Lana do të zgjatet nga Kashari deri në Shkozë. Duke vazhduar nga Lanabregas e poshtë deri në Kashar. Duke u zgjeruar kështu 2 km në Veri e 2 km në Jug. Disiplinimi i ujrave të një lumi në territore urbane tashmë të zhvilluara, është shumë i rëndësishëm dhe ka një impakt shumë pozitiv në

mjedis e komunitet. Përmes kësaj veprë madhore, qyteti do të fitojë shumë përmes disiplinimit të rrjedhës së lumit të Lanës duke ulur rrezikun e përmbytjeve, por edhe për krijimin e një ambienti pozitiv. Prania e një lumi për një qytet është shumë e rëndësishme. Disiplinimi i ujrave sjell transformimin e hapësirave publike, duke i transformuar ato në vlera për lagjen duke qenë se Lana ka qënë historikisht një shenjë e rëndësishme në territorin e qytetit dhe ka dhënë drejtimet për zhvillimin e tij.

TRANSPORTI I GJELBËR NË TIRANË

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti i projektit është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në transportin publik si dhe reduktimit të emetimeve të CO2 dhe ndotësve lokalë, duke kontribuar ndër të tjera, në mbrojtjen e klimës dhe mjedisit si dhe përmirësimet në efijencën e energjisë.

Projekti synon ndërtimin e BRT (Bus Rapid Transport), i cili është një sistem tranziti me cilësi të lartë i bazuar në autobuzë që lëvizin me bateri/energji elektrike dhe që ofrojnë shërbime të shpejta dhe komode me kosto efektive, në kapacitet pothuajse të nivelit të metrosë, por me investime shumë më të vogla. Kjo do të realizohet nëpërmjet ofrimit të korsive të dedikuara për autobusa dhe të aksesueshme nga të gjithë njerëzit, mbledhjen e tarifave jashtë autobuzit me veprime të shpejta dhe të shpeshta. BRT do të ketë prioritet nëpër kryqëzime në referencë me mjetet e tjera të transportit duke e bërë këtë sistem qarkullimi publik më të besueshëm dhe më komod për qytetarët e Tiranës.

Projekti i Transportit të Gjelbër në Tiranë do të financohet nga KFË, në emër të Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet një granti në vlerën 31.5 milionë euro dhe një kredie për Republikën e Shqipërisë, në vlerën 50 milionë euro, e cila do të kanalizohet nëpërmjet një marrëveshje nënshkruarë për Bashkinë e Tiranës. Gjithashtu projekti do të ketë financim nga buxheti i Bashkisë së Tiranës me një fond që parashikohet rreth 29 milionë euro, për një periudhë rreth 5 vjeçare.

3. BUXHETI AFATMESËM SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE NJËSIVE SHPENZUESE

Në këtë kapitull të PBA-së do të japim informacion në mënyrë të përmbledhur mbi njësitë shpenzuese: Aparati i Bashkisë dhe Institucionet e Varësisë lidhur me PBA-në dhe konkretisht qëllimet dhe objektivat për secilin nga programet buxhetore renditur si më poshtë:

- a. 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim
- b. 03140: Shërbimet e Policisë Vendore
- c. 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- d. 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
- e. 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve
- f. 04240: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
- g. 04260 :Administrimi i pyjeve dhe kullotave
- h. 04520: Rrjeti rrugor
- i. 04570: Transporti Publik
- j. 05100: Menaxhimi i mbetjeve
- k. 06140: Planifikimi Urban Vendor
- l. 06210: Programi I Zhvillimit
- m. 06260: Shërbimet publike vendore
- n. 08130: Sport dhe argëtim
- o. 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
- p. 09120: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
- q. 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm
- r. 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
- s. 10661: Strehimi social
- t. 04910: Fondi rezervë
- u. 04940: Fondi i Kontigjencës

4. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIU DHËN 2025-2027

Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2025-2027

Vlerësimi dhe parashikimi afatmesëm i të ardhurave është faza e parë për hartimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2025-2027. Legjislacioni mbi të cilin Bashkia Tiranë si njësi e vetëqeverisjes vendore mbështet funksionin e saj, si gjeneruese të ardhurash përbëhet nga aktet dhe nën-aktet ligjore si më poshtë:

- a. Ligji 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar
- b. Ligji nr. 9920, datë 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- c. Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- d. Ligji nr 9975 datë 28.07.2008, “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar
- e. Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- f. Ligji nr. 68/2017, datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, (*i ndryshuar*);
- g. Vendimi nr. 158 datë 26.12.2019 të këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” i ndryshuar;
- h. Udhëzimi nr. 23 datë 30.07.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, neni 59 dhe neni 60 (*i ndryshuar*).

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve janë mbështetur në nenin 34 të ligjit nr. 68/2017 datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar në të cilën citohet së:

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave bëhet për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.

Metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave

Parashikimi i të ardhurave është mbështetur në ecurinë e realizimit të tyre në vitet e mëparshme si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke i mbështetur në aktet ligjore për to.

Ndryshimet kryesore vijnë si pasojë e ndryshimeve të:

- Vendim nr. 457, datë 26.7.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar dhe ndikimi i ndryshimit të çmimeve mesatare të referencës për taksën e ndërtesës dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Kjo VKM në mënyrë jo të drejtpërdrejtë do të ndikojë dhe taksën e përkohshme të infrastrukturës arsimore duke pasur parasysh limitin e kësaj takse në masën 35% të detyrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
- Ndryshimi në tarifatat për ushqim si pasojë e ndryshimit të ndodhur si pasojë e rritjes së kostos së ushqimit në strukturat akomoduese të kopshteve dhe çerdheve.

Ky ndryshim vjen si pasojë e rritjes së kostove për shpenzime ushqimore nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve dhe ndryshimit respektiv të tarifës për të përballuar këto shpenzime të rritura. Ndryshimi është shumë i vogël duke pasur parasysh se kjo tarifë është e vetmja që paguhet nga prindërit e fëmijëve që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet dhe nuk paguhet asnjë shpenzim tjetër lidhur me ngrohjen, akomodimin dhe pastrimin e ambienteve.

- Ndryshime të lidhura me realizimin faktik dhe planifikimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Planifikimi afatmesëm merr parasysh dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në lidhje me taksat dhe tarifatat kryesore, përveç ngarkesës fiskale të viteve që parashikohen.
- Krijimi i institucioneve si institucione varësie me strukturë të vetën për arkëtimin dhe ndjekjen e detyrimeve të prapambetura ndikon gjithashtu në nivelet e parashikuara të të ardhurave, më specifikisht të ardhurat e parashikuara nga Institucionet e varësisë me dy komponentë të rëndësishëm të tyre, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

- Parashikimi i zërave që kanë lidhje me taksat kombëtare dhe Agjentet e tyre, që janë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, DPSHTRR dhe Drejtoria Rajonale Tatimore. Në lidhje me parashikimet e këtyre zërave bazohemi në ecurinë e realizimit të këtyre taksave në dy vitet e fundit përkundrejt planit, dhe planifikimit që kanë disa prej këtyre zërave, për shembull Tatimi mbi të ardhurat personale në Buxhetin e Shtetit për vitin aktual duke bërë shpërndarjen sipas formulës ekzistuese.

Parashikimi i të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 ndahet në dy grupe kryesore:

- Të ardhurat tatimore
- Të ardhurat jo-tatimore

Për vitin 2025 parashikimet për këto dy ndarje kryesore mbajnë respektivisht peshën 71% dhe 29%.

Parashikimi i këtyre zërave është bërë duke pasur parasysh kapacitetet mbledhëse, bazën tatimore dhe rritjen e numrit të subjekteve taksapaguese.

Drejtoritë dhe Institucionet që realizojnë të ardhurat kryesore janë të renditura si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime e reja dhe tarifën e shqyrtimit të lejes për punime
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore me taksën e ndërtesës, tarifën e pastrimit, taksën e reklamës dhe tarifën e zënies së hapësirës publike.
- Tirana Parking me tarifën e saj të parkimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Kopshteve dhe Çerdheve me tarifën e ushqimit

Parashikimi për të ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë për vitin 2025 duke krahasuar me planin e vitit 2024 janë afërsisht 1% më të larta në total.

Ecuria dhe ndryshimi në përqindje për zërat kryesorë që përbëjnë të ardhurat e veta duke krahasuar parashikimin e vitit 2025 me planin e vitit 2024 janë si më poshtë:

- 1- Taksa e ndërtesës me ulje nga viti 2024 me 6% për subjektet e biznesit, për shkak të ngarkesës për 5 muaj të detyrimit për vitin 2023 në këtë vit sipas ndryshimit të çmimeve mesatare sipas VKM 132 datë 7.03.2018 të ndryshuar.
- 2- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me një rritje në vlerë nominale në shumën 140 milionë lekë dhe në përqindje 2%
- 3- Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore në vitin e fundit të saj me një planifikim 5% më të lartë se plani i vitit 2024 duke pasur parasysh edhe mbledhjen e detyrimeve të prapambetura në lidhje me këtë taksë.
- 4- Tarifa e parkimit të automjeteve me një rritje prej 4% nga plani i vitit 2024 me parashikimin e rritjes së parkimit në sheshe dhe rrugë dhe rritjen e aftësisë mbledhëse.

5- Taksa e fjetjes në hotel me një rritje 5% nga plani i vitit 2024 duke u nisur nga rritja e frekuentimeve dhe rritja e strukturave akomoduese.

Në mijë lekë

Emërtimi	Fakt 2023	Plan 2024	Plan 2025	# %	Plan 2026	Plan 2027
Të ardhura tatimore	14,151,893	12,914,000	12,954,395	0%	12,039,017	12,095,541
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë"	2,393,152	3,803,000	3,646,000	-4%	3,690,000	3,726,900
Familjarët	668,405	868,000	876,000	1%	885,000	893,850
Subjektet Tregtare	1,724,747	2,935,000	2,770,000	-6%	2,805,000	2,833,050
Taksa mbi tokën bujqesore	24,596	34,500	34,845	1%	35,200	40,000
Taksa mbi truallin	86,050	90,000	90,900	1%	91,809	95,000
Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	27,214.00	-	-	-	-	-
Taksa e fjetjes në hotel	143,008	150,000	157,500	5%	165,375	173,644
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	9,395,507	6,360,000	6,500,000	2%	6,500,000	6,500,000
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	378,212	480,000	480,000	0%	480,000	480,000
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	513,486	490,000	490,000	0%	490,000	490,000
Tatimi mbi të ardhurat personale	225,340	250,000	250,000	0%	250,000	250,000
Taksa e tabelës	275,718	330,000	333,300	1%	336,633	339,997
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	594	250	250	0%	250	250
Tabelë reklamuese	275,124	329,750	333,050	1%	336,383	339,747
Taksa e përkohëshme për infrastrukturën Arsimore	689,610	926,500	971,850	5%	0	0
Familjarët	235,286	251,500	276,600	10%	0	0
Subjektet Tregtare	454,324	675,000	695,250	3%	0	0
Të ardhura jo tatimore	6,286,789	5,338,000	5,416,500	1%	5,464,935	5,528,482
Tarifat	4,160,773	4,047,200	4,125,500	2%	4,173,735	4,237,200
Tarifa e pastrimit	2,232,219	2,614,500	2,635,000	1%	2,661,000	2,687,610
Familjarët	712,146	827,500	835,000	1%	843,000	851,430
Subjektet Tregtare	1,520,073	1,787,000	1,800,000	1%	1,818,000	1,836,180
Tarifa e parkimit të automjeteve	566,360	623,000	647,000	4%	665,700	698,985
Parkim me kontratë	167,728	170,000	177,000	4%	184,700	193,935
Parkim me bileta	398,632	453,000	470,000	4%	481,000	505,050
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	981,557	450,000	480,000	7%	480,000	480,000
Tarifa dhenie licence tregtim karburanti +Lende djegese		0	0		0	0
Tarifa për zënie e hapësirave publike	372,234	350,000	353,500	1%	357,035	360,605
Tarifa për zënie e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella.	352,116	329,000	332,000	1%	335,035	338,385
Tarifa për zënie e hapësirave në tregjet publike	20,118	21,000	21,500	2%	22,000	22,220
Tarifa e shërbimit veterinar	0	0	0		0	0
Tarifa e shërbimit të MZSH	8,402	9,700	10,000	3%	10,000	10,000
Të ardhura të tjera	1,844,163	888,000	888,000	0%	888,000	888,000
Të ardhura nga qiratë	35,606	48,000	48,000	0%	48,000	48,000
Të ardhura të institucioneve të varësisë	229,881	240,000	240,000	0%	240,000	240,000
Të ardhura të tjera (penalite administrative; të padetajuara; etj.)	681,846	600,000	600,000	0%	600,000	600,000
Kontributi i subjekteve private në Fondin social	893,830	0	0		0	0
Pagesa	281,853	402,800	403,000	0%	403,200	403,282
Për kopshtet e fëmijëve	170,974	255,000	255,000	0%	255,000	255,000
Për qerdhjet e fëmijëve	99,330	140,000	140,000	0%	140,000	140,000
Për konviktet e Shkollave të Mesme	11,548	7,800	8,000	3%	8,200	8,282
Totali	20,438,683	18,252,000	18,370,895	1%	17,503,952	17,624,023

Më në detaje për taksat dhe tarifat kryesore po paraqesim parashikimet për vitet 2025-2027 duke marrë parasysh realizimin e viteve të mëparshme:

TAKSA VENDORE

A) Taksat mbi pasurinë e paluajtshme

a.1 Taksa mbi ndërtesën

Taksa mbi ndërtesën është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe përbën mesatarisht 16-18% të totalit të të ardhurave të veta.

Llogaritja e taksës për ndërtesën/njësi pronësore bazohet në shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, më specifikisht sipas pikes 5, te nenit 2, te VKM 132/2018, te ndryshuar, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Gjatë vitit 2023 u ndryshuan çmimet mesatare të shitjes së apartamenteve të banimit sipas VKM 457 datë 26.07.2023. Në lidhje me subjektet familjare këto ndryshime u aplikuan që në muajin gusht 2023 ndërsa për bizneset këto detyrime u ngarkuan në vitin 2024, siç mund të vërehet dhe në planin e vitit 2024 që është më i madh se planet e viteve pasardhëse 2025-2027.

Më poshtë paraqitet realizimi në vite i taksës mbi ndërtesën për kategorinë e subjekteve të biznesit:

në lekë

Taksa mbi ndërtesën	2019	2020	2021	2022	2023
Biznesi	1,605,209,838	1,380,326,027	1,643,669,627	1,598,986,567	1,724,746,933




Më poshtë shohim realizimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës ndër vite për kategorinë “Familjarë” të pasqyruar si më poshtë:

në lekë

Taksa mbi ndërtesën	2019	2020	2021	2022	2023
Familjarë	233,353,993	536,606,757	666,341,648	638,555,878	668,404,923

Gjithashtu paraqitja grafike si më poshtë:



Planifikimi i të ardhurave për periudhën 2025 – 2027 merr në konsideratë planifikimin për kategorinë e bizneseve në bazë të të dhënave të DPTTV, menaxhim më të mirë të të ardhurave të pambledhura dhe vlerave të reja të çmimeve të referencës, ndërsa për kategorinë familjare duke iu referuar faturimeve të muajit dhjetor 2023 si dhe trendin e arkëtimit në bazë të një vlerësimi paraprak, sipas të dhënave aktuale që disponohen nga baza e të dhënave e krijuar nga Agjenti Tatimor.

Në vitin 2025, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën janë parashikuar në vlerën 3,646,000,000 lekë.

Ky parashikim ka marrë parasysh mundësinë e vjeljes për më shumë subjekte si ato të biznesit dhe ato familjare.

Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa mbi ndërtesën	3,803,000,000	3,646,000,000	3,690,000,000	3,726,900,000
- Familjarët	868,000,000	876,000,000	885,000,000	893,850,000
- Subjektet Tregtare	2,935,000,000	2,770,000,000	2,805,000,000	2,833,050,000

a.2 Taksa mbi truallin

Realizimi i taksës mbi truallin gjatë viteve 2019-2023 paraqitet me rritje pavarësisht vështirësisë së identifikimit të pronarëve të truallit si pasojë e mos disponimit të një regjistri të rregullt.

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa mbi Truallin	56,079,090	50,714,059	65,136,671	85,213,072	86,050,092



Për vitet 2025 – 2027, parashikimi të ardhurave nga kjo taksë jepet në tabelë me një rritje prej 1% për dy vitet e para 2025 dhe 2026 dhe 3.5% për vitin 2027 krahasuar me 2026 :

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa mbi truallin	90,000,000	90,900,000	91,809,000	95,000,000

a.3 Taksa mbi tokën bujqësore

Realizimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore paraqitet në tabelën dhe grafikun më poshtë me një trend rritës po shumë larg vlerave të mundshme të realizimit që lidhen me identifikimin dhe regjistrimin e gjithë subjekteve që kanë në pronësi toka bujqësore:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa mbi tokën bujqësore	20,299,189	21,207,054	22,183,650	23,431,924	24,596,313



Bashkia e Tiranës është drejt finalizimit të regjistrimit të fermerëve të Tiranës, çka në vijim do të jetë një bazë e mirë të dhënash jo vetëm për t'u ardhur në ndihmë fermerëve, por dhe për efekt të taksimit të drejtë, bazë mbi të cilën është parashikuar një rritje në nivelin e arkëtimit nga kjo taksë për vitet në vijim.

Si një reagim ndaj potencialit më të madh të arkëtimit kemi parashikuar vlera më të mëdha për vitet në vazhdim paraqitur si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa mbi tokën Bujqësore	34,500,000	34,845,000	35,200,000	40,000,000

B) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit më parë të vlerës sipas përcaktimeve ligjore.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë tejkalon planin e miratuar si rrjedhojë e aplikimeve përtej parashikimeve dhe në vitin 2023 realizimi nga kjo taksë shënon vlerën më të lartë ndër vite.

Ndryshe nga cdo fushë tjetër e aktivitetit tregtar, sektori i ndërtimit ka vazhduar të jetë një prej shtyllave bazë të zhvillimit ekonomik dhe njëri prej aktiviteteve që sjell më shumë të ardhura.

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,315,307,289	6,350,959,457	7,438,141,907	7,414,035,966	9,395,507,091

Referuar vlerësimeve të drejtorisë përgjegjëse pritet që ecuria e arkëtimit për vitet 2025-2027 të jetë nën nivelin e viteve të fundit.

Konkretisht parashikimet për këtë taksë, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,360,000,000	6,500,000,000	6,500,000,000	6,500,000,000

B) Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitete ekonomike në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa detyrimi nga kategoria familjarë arkëtohet nga agjenti tatimor i përzgjedhur për këtë qëllim, Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.


Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore ka një realizueshmëri të kënaqshme që nga koha e hyrjes në fuqi, në vitin 2016, si për kategorinë biznese edhe për kategorinë familjarë. Në vitin 2023 kjo taksë e përkohshme u miratua dhe për një periudhë 3 vjeçare.

Të dhënat e ecurisë paraqiten në tabelën më poshtë:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore	699,773,149	649,392,794	756,967,278	759,519,645	689,610,468

Për periudhën 2025 – 2027, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:



Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore e ka vitin e fundit të aplikimit vitin 2025.

kufij maksimalë realizimit të pritshëm të taksës mbi pasurinë e paluajtshme ‘ ndërtesë” për të dy kategoritë e taksapaguesve.

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore	926,500,000	971,850,000	0	0
Familjarët	251,500,000	276,600,000	0	0
Subjektet Tregtare	675,000,000	695,250,000	0	0

C) Taksa e tabelës

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesioneve të lira.


Tipologjia e tabelës përbëhet nga tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo brenda territorit të zhvillimit të aktivitetit, tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit, tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në tavanin 35 m², tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda, etj.

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite është përgjithësisht e qëndrueshme edhe pse arkëtimet nga kjo taksë varen nga përdorimi i tabelave reklamuese nga ana e bizneseve, i cili është i ndryshueshëm në varësi të zgjedhjes së biznesit për të reklamuar ose jo në një vit të caktuar, ndërkohë që për tabelën për qëllime identifikimi, deri në 2 m² masa e taksës është zero.

Realizimi në vite pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa e tabelës dhe reklamës	268,203,139	236,214,879	260,113,743	296,186,327	275,718,201

në lekë



Referuar realizimit të të ardhurave për vitin 2023, nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, si dhe vlerësimeve paraprake mbi përdorimin e tabelave reklamuese, parashikimi i të ardhurave për vitet 2025 – 2027, paraqitet në tabelën si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa e tabelës	330,000,000	333,300,000	336,633,000	339,997,000
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	250,000	250,000	250,000	250,000
Tabelë reklamuese	329,750,000	333,050,000	336,383,000	339,747,000

D) Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Subjekte hoteleri me 4–5 yje me nivel takse për 350 lekë/dhoma;
- Subjekte hotele, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin në nivel takse për 140 lekë/dhoma

Performanca e kësaj takse ndër vite paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa e fjetjes në Hotel	113,966,275	35,815,582	67,226,382	111,515,607	143,008,426



Bazuar në të dhënat historike të realizimit të arkëtimit, parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel për vitet 2025-2027 duke marrë parasysh kthimin në normalitet të levizje së lirë dhe frekuentimit të këtyre strukturave hoteliere paraqitet si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa e fjetjes në hotel	150,000,000	157,500,000	165,375,000	173,644,000

TARIFA VENDORE

E) Tarifa e pastrimit

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mbledhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjellës – Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë.

Paraqitja në vite e mbledhjes së këtyre të ardhurave është si më poshtë:


	në lekë				
Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Tarifa e pastrimit Familjarë	651,984,449	726,552,679	790,364,210	761,759,858	712,146,029



Lidhur me tarifën e pastrimit nga kategoria biznesi, vihet re një ecuri pozitive që tregon një ritëm në rritje të arkëtimeve në katër vitet e fundit, në sajë të mirëadministrimit të saj nga strukturat e DPTTV.

E njëjta tarifë për kategorinë “subjekte tregtare” paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

	në lekë				
Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Tarifa e pastrimit Subjekte	1,138,546,202	1,215,758,389	1,448,405,768	1,538,436,158	1,520,073,424



Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetin e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve aktive të evidentuara dhe nivelin e tarifës për vitin ushtrimor, në të ardhurat që trajtohen nga strukturat e DPTTV që do të kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti do të ndjekin edhe mbledhjen e tyre.

Për kategorinë familjarë parashikimi është bazuar në numrin e familjeve raportuar nga Agjenti tatimor.

Për vitet 2025-2027, parashikimi i arkëtimit të tarifës së pastrimit për kategorinë familjarë dhe subjektet tregtare, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Tarifa e pastrimit	2,614,500,000	2,635,000,000	2,661,000,000	2,687,610,000
- Familjarët	827,500,000	835,000,000	843,000,000	851,430,000
- Subjektet Tregtare	1,787,000,000	1,800,000,000	1,818,000,000	1,836,180,000

F) Tarifa për zënien e hapësirave publike

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m² të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit të indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.


Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo, etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.
- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike paraqiten në nivelet e mëposhtëme në formë tabelare dhe grafike:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Tarifa per zënie e hapësirave publike	385,666,800	223,680,468	276,055,695	346,830,117	372,234,181

në lekë



Parashikimi i të ardhurave të kësaj tarife për vitet 2025 - 2027, është si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Tarifa për zënie e hapësirave publike	350,000,000	353,500,000	357,035,000	360,605,000
Tarifa për zënie e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella.	329,000,000	332,000,000	335,035,000	338,385,000
Tarifa për zënie e hapësirave në tregjet publike	21,000,000	21,500,000	22,000,000	22,220,000

në lekë

G) Tarifa e parkimit

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia Tiranë për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara.

Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranë është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Realizimi në vite dhe pritshmëria për vitet 2019-2023 paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	2019	2020	2021	2022	2023
Tarifa e parkimit	469,401,688	400,015,660	498,689,407	530,063,937	566,360,290

në lekë



Parashikimi i të ardhurave të realizuara nga tarifat e parkimit nga Tirana Parking për vitet 2025-2027 për parkimin në rrugë është bërë duke marrë parasysh kapacitetet e rrugëve me tarifim të cilat nga numërimi i fundit faktik në terren rezultojnë të jenë 2305 vende parkimi me pagesa.

Të ardhurat nga sektori i inspektimit në rrugë përveç shtimit të vendeve të reja është parashikuar të rriten dhe si pasojë e dy faktorëve të tjerë si:

- Shtimi i një metode të dytë alternative të pagesës së shërbimit të parkimit
- Shfrytëzimi më efikas i vendparkimeve aktuale

Në të njëjtën kohë është marrë parasysh vështirësia në realizim e të ardhurave që vjen si pasojë e dy faktorëve të mëposhtëm:

- Duke qenë se gjoba për mospagesën e tarifës së parkimit vendoset dhe arkëtohet nga Policia Bashkiake sjell vështirësi në realizimin e planit të parashikuar.
- Bllokime të rrugëve për shkak të kantierëve të ndërtimeve, punimeve në rrugë dhe aktiviteteve.

Së dyti, pritet të rritet numri i subjekteve që operojnë si “taksi” dhe duke bërë të mundur rritjen e të ardhurave për vitin 2025 e në vazhdim.

Së treti, numri i abonimeve i cili pretendohet të rritet duke marrë parasysh:

- Heqja e disa prej rrugëve me kapacitet të konsiderueshëm të vendparkimeve të Zonës A do të sjellë rritje të numrit të abonimeve.
- Tarifat ekonomike të shesheve të parkimit në zonën B në rrugë gjithashtu ndikojnë për rritjen e numrit të abonimeve.

Së fundmi, duke marrë parasysh gjithë elementët e mësipërm dhe interesit të shprehur për kontrata të reja dhe rinovim të atyre ekzistuese nga subjektet private, edhe ky zë i të ardhurave të parashikuara nga Tirana Parking parashikohet të rritet mesatarisht me 4%.

Parashikimet për arkëtimin e tarifës së parkimit për vitet 2025-2027, paraqiten si më poshtë:

në

lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Tarifa e parkimit te automjeteve	623,000,000	647,000,000	665,700,000	698,985,000
Parkim me kontratë	170,000,000	177,000,000	184,700,000	193,935,000
Parkim me bileta	453,000,000	470,000,000	481,000,000	505,050,000

H) Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime

Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, vetëm një herë për të njëjtin aplikim për leje zhvillimi, infrastrukture dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit. Siç mund të vihet re kemi një ulje të kësaj tarife pasi më parë kjo tarifë paguhej për cdo aplikim pavarësisht se lidheshin me të njëjtin ndërtim objekti.

Realizimi i të ardhurave nga kjo tarifë për periudhën 2019-2023 paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	2019	2020	2021	2022	2023
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	477,529,142	594,764,275	664,327,871	324,432,169	981,557,418



Parashikimi për tarifën e shqyrtimit e kërkesës për leje për punime për vitet 2025 – 2027, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	450,000,000	480,000,000	480,000,000	480,000,000

I) Të ardhura të tjera

Në të ardhurat e tjera përfshihen kryesisht të ardhura destinacioni i të cilave nuk identifikohet që në momentin e arkëtimit dhe shpërndahen në destinacionet përkatëse sipas rakordimeve që realizohen nga DPTTV. Gjithashtu këtu përfshihen edhe të ardhurat nga qeratë e ndërtesave dhe trojeve, të ardhura nga penalitete administrative apo gjoba të vendosura nga DPTTV apo strukturave të tjera si Policia Bashkiake, Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorëve, etj. Ky parashikim mbart vlerën 600 milionë leke për të tre vitet 2025-2027, në të njëjtën vlerë që është parashikuar dhe në vitet e mëparshme.

J) Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji.

në lekë

Lloji i të ardhurave	2019	2020	2021	2022	2023
Të ardhura DPÇK	203,445,619	139,884,930	216,992,553	241,513,594	270,304,492
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	128,533,229	89,124,960	138,846,520	156,159,803	170,974,027
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	74,912,390	50,759,970	78,146,033	85,353,791	99,330,465

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2025 – 2027 paraqitet si më poshtë vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	255,000,000	255,000,000	255,000,000	255,000,000
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	140,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve.

Të ardhurat e mbledhura nga pagesat e konvikteve të shkollave të mesme si më poshtë:

në

lekë

Lloji i të ardhurave	2019	2020	2021	2022	2023
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	6,103,881	4,572,310	4,777,298	9,745,085	11,548,175



Parashikimi i të ardhurave nga pagesa në Konviktet e Shkollave të Mesme, për vitet 2025 – 2027, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	7,800,000	8,000,000	8,200,000	8,282,000

AGJENTËT TATIMORË JASHTË BASHKISË TIRANË

K) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.

Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme.

Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1,000 lekë/m² dhe për objektet e biznesit është 2,000 lekë/m². Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara.

Ecuria në vite për këtë taksë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	326,363,132	365,273,593	445,977,729	538,304,919	378,211,917

Bazuar në ecurinë faktike të viteve të kaluara, realizimin më të lartë të vitit 2022 krahasuar me vitet e mëparshme dhe në informacionin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, parashikimi për vitet 2025 – 2027, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	480,000,000	480,000,000	480,000,000	480,000,000

L) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tiranë), para kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjetit, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuara për çdo muaj nga agjentët tatimor të DPSHTRR.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura nga viti 2019 deri në vitin 2023, paraqitet në tabelen e mëposhtme:

në lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	433,146,135	442,712,995	466,305,347	490,556,445	513,485,561



Parashikimi për vitet 2025– 2027 duke marrë parasysh ecurinë e të ardhurave ndër vite dhe realizimin për vitin 2023 paraqitet si vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	490,000,000	490,000,000	490,000,000	490,000,000


M) Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale që u takon Njësive të qeverisjes vendore përfaqësojnë vlerën 2% e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Vlen të bëjmë me dije se për vitet 2018 dhe 2019, nuk është evidentuar asnjë e ardhur nga ky burim, ku strukturë mbledhëse është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, edhe pse ligji ka hyrë në fuqi që më 1 janar 2018, ndërsa gjatë periudhës 2020-2023 janë paguar shumat e mëposhtme duke marrë si bazë llogaritje përqindjen e numrit të banorëve për Bashkinë e Tiranës kundrejt numrit total të banorëve në vend.

në lekë

Lloji i të ardhurave	2019	2020	2021	2022	2023
Tatimi mbi të ardhurat personale	0	115,736,351	153,892,321	175,245,014	225,340,009



Në parashikimet nga kjo taksë, ndryshimi në krahasim me parashikimet e mëparshme i atribuohet edhe mënyrës së shpërndarjes ndërmjet bashkive i të ardhurave të përgjithshme të njësive vendore nga TAP. Ndërkohë që sipas parashikimeve fillestare ligjore shpërndarja do të duhej të bëhej sipas juridiksionit ku mblidhet taksa, për arsye të pamundësisë teknike, sipas MFE, shpërndarja është bërë në bazë të numrit të popullsisë të njësive vendore. Në këtë mënyrë pjesa takuese për Bashkinë e Tiranës është më e ulët se ç'do të ishte nëse shpërndarja do të bëhej në bazë juridiksioni.

Bashkia e Tiranës, për vitet 2025–2027, nisur nga llogaritjet e përafërta mbi përkatësinë e pjesës takuese nga totali i parashikuar nga DPT, ka parashikuar të njëjtin nivel të ardhurash për BT, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Tatimi mbi të ardhurat personale	250,000,000	250,000,000	250,000,000	250,000,000

5. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2025-2027

5.1. Transfertat nga Buxheti i Shtetit dhe Fonde të mbartura


Transferta e Pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr.68 datë 27.04 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" , ligjit vjetor të buxhetit si dhe udhëzimeve plotësues.

Ecuria e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës për periudhën 2018 – 2025 paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Emertimi	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Transferta e pakushtezuar	2,138,631	2,348,723	242494236%	2,438,117	2,523,451	3,008,634	3,732,530	4,124,805
Trendi i rritjes	11%	9%	3%	1%	3%	3%	19%	11%



Transferta e pakushtezuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2025, do të jetë në vlerën 4,124,805,000 lekë, me një rritje prej 11 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Kjo transfertë përbën rreth 11% të buxhetit të planifikuar për vitin 2025.

Transferta e pakushtezuar duhet t’i sigurojë Njësitë të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostosë ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur. Në vitin 2025, ashtu sikurse edhe në vitin 2024, transferata e pakushtezuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Në të tre vitet buxhetore 2025-2027 pjesë e transfertës së pakushtezuar të përgjithshme është dhe fondi për rritjen e pagave për Bashkinë e Tiranës të cilin nuk e kemi detajuar në buxhetin që po prezantojmë për ta bërë gjatë fazës së dytë të përgatitjes së PBA 2025-2027 në vijim të VKM-ve që priten të miratohen për ndryshime në shpenzimet e personelit.

Transferta e Pakushtezuar Sektoriale

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” si Transferata Specifike do të vazhdojnë të financohen edhe në buxhetin e vitit 2024 nëpërmjet Transfertës së pakushtezuar sektoriale. Më konkretisht:

- Konviktet e arsimit para universitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)
- Personeli mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jo mësimor në arsimin para universitar

- Rrugët rurale
- Administrimi i pyjeve
- Ujitja dhe kullimi
- Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Ecuria e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për Bashkinë e Tiranës për periudhën 2017 – 2025 paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Emertimi	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Transferta e pakushtezuar sektoriale	992,080	1,159,434	1,176,039	1,368,453	1,269,437	1,324,955	1,447,328	1,461,302
Trendi i rritjes	12%	14%	1%	14%	-8%	4%	8%	5%



Transferta e pakushtëzuar sektoriale nga Buxheti i Shtetit për vitin 2025, do të jetë në vlerën 1,461,801,523 lekë, me një rritje prej 5 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Kjo rritje është rreth 3-4 % për cdo funksion të deleguar përveç funksionit të Klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Në transfertën e këtij viti janë përfshirë dhe fondet shtesë akorduar për të përballuar efektin financiar të pagave.



Transfertat e Kushtëzuara

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, Bashkia e Tiranës nuk i miraton si pjesë përbërëse e buxhetit të njësive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor si dhe fonde të kushtëzuara që priten të akordohen në vijim si rezultat dhe i angazhimeve buxhetore janë si më poshtë:

Shërbimi i gjendjes civile si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Përkrahja sociale, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

Fonde të tjera që janë deleguar dhe priten të delegohen në vazhdim nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për projekte madhore janë si më poshtë:

- Subvencionim i qerave për familjet e prekura nga tërmeti
- Subvencionim i qerave për familjet e prekura nga shpronësimi
- Bursa

- Transferime
- Godina e Teatrit
- Fond për mbrojtjen civile në zbatim të VKM 414

Parashikim Fonde të mbartura

Fondet e mbartura përfaqësojnë gjendjen në fund të vitit buxhetor të likuiditeteve të pashpenzuara brenda vitit, për arsye të ndryshme, dhe të cilat, sipas legjislacionit, trashëgohen për t'u përdorur në vitin pasardhës.

Në mbyllje të vitit 2024, Bashkia e Tiranës parashikohet të ketë një gjendje likuiditetesh të papërdorur, për t'u trashëguar në vitin 2025, në vlerën 5,000,000,000 lekë, 3,000,000,000 lekë në vitin 2026 dhe 2027.

Arsyet që kanë ndikuar këtë nivel të fondeve të trashëguara sqaruar dhe në relacionin e PBA 2024-2026 apo dhe në raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 janë:

1. Trashëgimi nga vitet e mëparshme. Që prej 2019, realizimin faktik i buxheteve, është përfshirë në një rrjedhë jo të natyrshme, që lidhet me dy ngjarje madhore, emergjenca civile, ajo e pandemisë dhe tërmetit. Të dyja këto situata kanë impaktuar buxhetin e viteve 2019, 2020 dhe 2021, nga ku ka filluar në fakt të rritet gjendja e fondeve të trashëguara që deri në këtë moment ka qenë në një trend normal (jo më shumë se 10% e buxhetit total). Situata e pandemisë në vitin 2020, e shtrirë edhe në vitin 2021, fokusimi i vëmëndjes për realizimin me prioritet të programeve të rindërimit, gjatë këtyre viteve, kanë ndikuar në akumulimin e likuiditetit nga të ardhurat e veta, vit pas viti. Duhet përmendur gjithashtu, se të gjitha vitet e fundit, janë paraqitur me tejkalim të planit të të ardhurave, i cili lidhet më së shumti me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Parashikimi i TNI me saktësi, është i vështirë, pasi lidhet me ngarkesën e aplikimeve, e cila nuk mund të parashikohet me saktësi. Nga ana tjetër parashikimi në nivele të larta na vendos përballë riskut të mosrealizimit të të ardhurave.
2. Për arsyet të cilat do të afektojnë edhe periudhën në vijim, zëri "fonde të mbartura" është shtrirë për të gjithë periudhën e PBA-së, për të reflektuar një parashikim më realist të pritshmërisë tre vjeçare. Në këtë parashikim është marrë parasysh një normë mos-realizimi i shpenzimeve të planifikuara parimisht deri në 10%, duke konsideruar fondet e mbartura për vitin 2024, të cilat janë në një masë të konsiderueshme, por edhe arsye të tjera që mund të cojnë në mosrealizim.

5.2 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2025 -2027

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2025 - 2027, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 28,957,501,523 lekë, 26,266,729,539 lekë dhe 26,570,388,734 lekë.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për vitet 2024-2026, parashikohen të ndara në formë tabelare dhe grafiksht si më poshtë sipas kategorisë ekonomike dhe sipas klasifikimit funksional.

Krahasimisht me vitin 2024, është ruajtur i njëjti trend planifikimi buxheti në programet e planifikim menaxhim administrimit, mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes civile si dhe policisë bashkiake ndërsa në programet e rrjetit rrugor, urbanistikës, shërbimeve publike vendore është planifikuar që do të realizohen fillimisht projektet në vazhdim në buxhetin e vitit 2024 e më pas do rishikohet kapaciteti për planifikimin e investimeve të reja. Programi i mbetjeve është parashikuar me rritje krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2024 por në të njëjtin trend me buxhetin e rishikuar të vitit 2024 kjo në vijim të ndryshimeve të bëra me Vendim Këshilli Bashkiak për zgjerimin e territorit për mbulimin e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane nga shoqëria “Eco Tirana” sh.a., në Bashkinë e Tiranës, dhe miratimin e sistemeve të reja teknologjike për grumbullimin dhe transportimin.

Programet e Arsimit Parauniversitar dhe Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm janë planifikuar me rritje kjo në vijim të strategjisë së Bashkisë Tiranë për ndërtimin e kopshteve, cerdheve dhe shkollave të reja.

Programi i Strehimit Social është parashikuar më ulje duke qenë se kontributi i subjekteve private në fondin publik të banesave sociale i cili nuk do të vijojë të mblidhet më në vlerë monetare është parashikuar në vlerën 710,000,000 lekë në vitin 2025 dhe 0 për dy vitet e tjera kundrejt një përdorimi të këtij fondi të parashikuar në buxhetin e vitit 2024 për 5 mujorin në vlerën 0.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

Shpenzimet Totale te Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike

Në mijë lekë

Nr.	Funksioni	Plan 2024	Plan 2025	% ne strukturë	Plan 2026	Plan 2027
1	Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	4,617,189	4,498,102	16%	4,475,602	4,474,602
2	Shërbime policore	762,045	739,643	3%	739,643	739,643
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	348,386	342,881	1%	342,931	342,931
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	748,160	727,513	3%	698,407	454,233
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	465,423	423,426	1%	407,528	408,486
6	Transporti	5,604,926	4,296,687	15%	3,504,166	3,344,112
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi I ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	2,916,889	3,230,000	11%	3,230,000	3,230,000
8	Urbanistika	1,624,906	1,383,109	5%	1,049,901	1,433,109
9	Zhvillimi i komunitetit	4,992,063	3,391,390	12%	3,207,390	3,476,153
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	551,330	554,812	2%	539,812	534,812
11	Shërbimet kulturore	982,612	992,080	3%	907,680	905,140
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	3,684,455	4,048,692	14%	3,636,182	3,748,582
13	Arsimi parauniversitar	2,196,350	2,236,103	8%	2,341,103	2,441,103
14	Familja dhe fëmijet, Te moshuarit, Semundjet dhe paaftesia	391,776	393,614	1%	392,934	393,034
15	Strehimi Social	3,271,729	1,359,450	5%	453,450	304,450
16	Fondi rezerve	141,300	300,000	1%	300,000	300,000
17	Fondi I Kontigjences	140,000	40,000	0%	40,000	40,000
TOTALI		33,439,540	28,957,502	100%	26,266,730	26,570,389

III.4.2. Shpenzime Kapitale

Për vitin 2025 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 8,994,750,137 lekë dhe zë 39% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2026 dhe 2027, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 6,686,492,589 lekë dhe 7,240,862,769 lekë. Për vitin 2025 peshën më të madhe e zënë shpenzimet kapitale të Transportit dhe Zhvillimit të Komunitetit.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2024 - 2027, sipas programeve buxhetore:

Në mijë lekë

Nr.	Funksioni	Plan 2024	Plan 2025	% ne strukturë	Plan 2026	Plan 2027
1	Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	306,642	130,000	1%	130,000	130,000
2	Shërbime policore	37,400	25,000	0%	25,000	25,000
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	75,160	79,950	1%	80,000	80,000
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	558,159	540,000	6%	545,000	295,000
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	108,120	65,000	1%	60,000	60,000
6	Transporti	3,843,449	2,700,000	30%	1,960,000	1,900,000
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi I ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	-	-	0%	-	-
8	Urbanistika	1,225,440	985,000	11%	626,793	1,010,000
9	Zhvillimi i komunitetit	3,092,971	1,455,000	16%	1,316,000	1,584,763
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	25,100	11,000	0%	11,000	11,000
11	Shërbimet kulturore	227,559	163,700	2%	114,500	114,500
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	1,006,726	1,315,000	15%	898,600	1,011,000
13	Arsimi parauniversitar	782,525	805,000	9%	910,000	1,010,000
14	Familja dhe fëmijet,Te moshuarit,Semundjet dhe paafesia	9,228	10,100	0%	9,600	9,600
15	Strehimi Social	2,730,279	710,000	8%	-	-
16	Fondi rezerve	-	-	0%	-	-
17	Fondi I Kontigjences	-	-	0%	-	-
	TOTALI	14,028,758	8,994,750	100%	6,686,493	7,240,863

III.4.3. Shpenzime për Personelin

Shpenzimet e personelit janë bazuar në ndryshimet e fundit të pagave të vitit 2023, pra nuk propozohet as rritje në numrin e punonjësve si dhe as rritje në efekte financiare. Në rast të politikave të reja nacionale dhe miratimit të VKM-ve , do të bëhen vlerësimet e nevojshme në fazën të mëtejshme të hartimit të PBA-së.

Më poshtë gjeni të pasqyruara shpenzimet e personelit për vitet 2024 – 2027 në mënyrë tabelare.

Nr.	Funksioni	Plan 2024	Plan 2025	% ne strukturë	Plan 2026	Plan 2027
1	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	2,729,588	2,984,439	32%	2,984,439	2,984,439
2	Shërbime policore	666,114	667,769	7%	667,769	667,769
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	185,004	185,004	2%	185,004	185,004
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	52,640	55,841	1%	55,841	55,841
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	218,481	219,437	2%	219,437	219,437
6	Transporti	683,529	709,499	8%	709,499	709,499
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi i ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	0	0	0%	0	0
8	Urbanistika	219,032	218,737	2%	218,737	218,737
9	Zhvillimi i komunitetit	1,040,418	1,046,551	11%	1,046,551	1,046,551
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	102,276	96,095	1%	96,095	96,095
11	Shërbimet kulturore	218,683	223,696	2%	223,696	223,696
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	1,855,811	1,869,156	20%	1,869,156	1,869,156
13	Arsimi parauniversitar	901,217	916,343	10%	916,343	916,343
14	Familja dhe femijet,Te moshuarit,Semundjet dhe paafesia	201,950	206,104	2%	206,104	206,104
15	Strehimi Social	0	0	0%	0	0
16	Fondi rezerve	0	0	0%	0	0
17	Fondi i Kontigjencës	0	0	0%	0	0
	TOTALI	9,074,743	9,398,671	100%	9,398,671	9,398,671

III.4.4. Shpenzime Operative dhe të tjera korrente

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 10,564,080,286 lekë për vitin 2025, 10,181,565,850 lekë për vitin 2026 dhe 9,930,854,865 lekë për vitin 2027.

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatëhartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak.

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i strehimit, dëmshpërblime në raste fatkeqësish natyrore, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si shporta e bebes , të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë viteve 2025-2027.

Shpenzimet operative dhe të tjera për vitet 2025 - 2027 parashikohen sipas programeve buxhetore si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Funksioni	Plan 2024	Plan 2025	% ne strukturë	Plan 2026	Plan 2027
1	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	1,580,959	1,383,662	13%	1,361,162	1,360,162
2	Shërbime policore	58,531	46,874	0%	46,874	46,874
3	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	88,222	77,927	1%	77,927	77,927
4	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	137,361	131,673	1%	97,567	103,392
5	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	138,822	138,989	1%	128,091	129,048
6	Transporti	1,077,948	887,187	8%	834,666	734,613
7	Menaxhimi i mbetjeve ,Reduktimi I ndotjes,Mbrojtja e mjedisit	2,916,889	3,230,000	31%	3,230,000	3,230,000
8	Urbanistika	180,434	179,372	2%	204,372	204,372
9	Zhvillimi i komunitetit	858,674	889,839	8%	844,839	844,839
10	Shërbimet rekreative dhe sportive	423,954	447,717	4%	432,717	427,717
11	Shërbimet kulturore	536,370	604,684	6%	569,484	566,944
12	Arsimi bazë dhe parashkollor	821,919	864,535	8%	868,426	868,426
13	Arsimi parauniversitar	512,608	514,761	5%	514,761	514,761
14	Familja dhe fëmijet, Te moshuarit, Semundjet dhe paafesia	180,598	177,410	2%	177,230	177,330
15	Strehimi Social	541,450	649,450	6%	453,450	304,450
16	Fondi rezerve	141,300	300,000	3%	300,000	300,000
17	Fondi I Kontigjences	140,000	40,000	0%	40,000	40,000
	TOTALI	10,336,039	10,564,080	100%	10,181,566	9,930,855

Referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.3 datë 28.02.2024 për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027, faza e parë e kësaj PBA-je është përgatitur sipas formateve pjesë e sistemit të menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) risi e mënyrës së planifikimit të buxhetit për qeverisjen vendore. Pavarësisht se për Bashkinë e Tiranës ky proces pati vështirësi referuar dinamikave që ka vetë buxheti, problematika për të cilat Bashkia e Tiranës njoftoi zyrtarisht Ministrinë e Financave, u regjistruan dhe u kryen në SMBV të gjitha fazat e planifikimit.

Në vijim po paraqesim të gjitha formatet standart sipas këtij moduli sistemi pjesë e PBA 2025-2027 si dhe deklaratat e politikave për çdo program buxhetor, produktet dhe objektivat përkatëse.